

• **STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT**
"BREÇANI" SH.P.K

STATUT
DHE
AKT THEMELIMI

I SHOQERISE "BREÇANI" SH.P.K.

Sot me date 09.09.2022 ne cilesine e Ortakut Themelues une:

Z. Erzen BREÇANI, i biri i Ali-ut , i datëlindjes 04.06.1970 , i lindur ne Markaj, Bajram Curri dhe banues në Tirane , person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 034249278 dhe nr. personal H00604186T, ne cilesine e Ortakut Themelues me vullnetin e tij te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi une ortaku:

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit” , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoqerite tregtare” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Q.K.B dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, ka themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuara me emertimin "Breçani" shpk *(me poshte e quajtur Shoqeria)*.

NENI 1

FORMIMI

Shoqeria "Breçani" sh.p.k eshte person juridik i krijuar sipas legjislacionit dhe se drejtes Shqiptare.

NENI 2

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria fiton personalitet juridik pasi te jete regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne Ligj.

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te jete ne adresen : Rr. "Papa Gjon Pali II. ABA Business Center, K. perdhe, z. 01, Tirane".

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:



STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
"BREÇANI" SH.P.K

Investim, Operim, Prodhim, shfrytezim, shitje i kapaciteteve prodhuese te energjise elektrike nga te gjitha burimet e rinovueshme e energjise elektrike si dhe te gjitha veprimtarite e tjera ligjore qe rrjedhin nga aktiviteti tregtar i energjise elektrike.

Ne fushen e ndertimi shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore.

Aktivite ne fushen e bujqesise, investim, kultivim, prodhim, perpunim, tregtim me shumice dhe pakice e produkteve apo nenprodukteve bujqesore, bime medicinale etj.

Sherbimi i ruajtjes dhe i sigurise fizike te personave dhe objekteve dhe sherbime te ruajtjes, (I.3.A) dhe trnsportim te vlerave monetare e sendeve te çmuara (I.3.B). Importim, tregtim dhe instalim te mjeteve te sistemit vrojtues, sinjalizues, audioviziv, mjeteve te mbrojtjes kundra zjarrit, paisjeve te nderlidhjes te teknikave te tjera te lejuara si dhe projektim, instalim dhe programimin e paisjeve te telekomunikacionit, radiokomunikacionit dhe sistemeve te kontrollit dhe monitorimit ne distance te automjeteve. Shitje paisje kompjuterike. Import dhe eksport, instalim, sherbim, mirembajtje, tregti me pakice dhe shumice te pajisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, te telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, kabull etj. Sherbime informatike dhe telefonike Shperndarje interneti.

Krijim dhe mirembajtje faqesh interneti. Krijim dhe shperndarje programe kompjuterike. Konsulence teknike dhe riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Konsulence sigurie. Tregtim, instalim, import dhe eksport, mirembajtje te sistemit te fonise, sistemeve te alarmit kundra vjedhjes, sistemeve te alarmit kundra zjarrit, vezhgimit CCTV, sistemeve te aksesit te kontrollit, sisteme aparaturash mjeksore, sisteme UPS, sisteme elektrike te fuqive te larta dhe te mesme, stabilizatore, gjeneratore, radio nderlidhese, sisteme me fiber optike, akses kontrolli, aplikim grafik, tregtim dhe sherbim te kondicionerëve etj.

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat pacaktuar. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkakut qe nga momenti I regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 6

KAPITALI I SHOQERISE.

Kapitali fillestar i shoqerise "Breçani" sh.p.k do te jete ne vleren 100 000 ALL.

Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakut te vetem, e ndare ne 1 kuote .


Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Kpitali I Shoqerise Zoterohet nga Ortaku I Vetem i Shoqerise Erzen Breçani.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise .

NENI 7

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT



STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
"BREÇANI" SH.P.K

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te Kapitalit Themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses se Administrstorit.

Zvogelimi i kapitalit realizohet me Vendim te Ortakut te Vetem ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e Statutit. Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar ne rast se ka te tille, te pakten 45 dite perpara dates se mbledhjes se Ortakut te Vetem te thirrur per te marre vendim rreth ketij projekti.

Zvogelimi i kapitalit themeltar me nje vlere me te vogel te se ajo e percaktuar ne Nenin 6 e ben te detyrueshem marrjen e nje vendimi per zvogelimin e kapitalit themeltar deri ne vleren minimale. Ne te kundert shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter. Ne rast te moszbatimit te kerkesave te ketij paragrafi cdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise. Kjo prishje nuk mund te shpallet ne rast se rregullimi eshte bere ne ditën kur gjykata mblidhet per te marre vendimin.

NENI 8

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri vetem me miratimin e Ortakut te Vetem.

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te trasferueshme dhe ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve.

Gjithashtu jane te transferueshme nepermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve nepermjet akteve ligjore.

KREU II

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 9

ORGANI VENDIMARRES

Organi me i larte dhe i vetem vendimarrës i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetëve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve brenda nje afati 6 (gjashte) mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin, dhe llogarite vjetore te hartuara nga administrator.


Ai mund te perfaqesohet dhe nga nje person tjeter nepermjet autorizimit apo prokures.

NENI 10

NDRYSHIMET NE STATUT

Ndryshimet ne Statut vendosen nga Asambleja e Ortakeve Shoqerise. Cdo ndryshim i statutit duhet te depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit, per ti pasqyruar me pas ne Ekstraktin e Shoqerise.

NENI 11



**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
"BREÇANI" SH.P.K**

ADMINISTRIMI

Administratori emerohet dhe shkarkohet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve. Kjo e fundit vendos per sistemin e administrimit dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratoret mund te jene ose jo ortake.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo kohe.

Administrator I shoqerise " Breçani "sh.p.k eshte Z. Erzen Ali Breçani, i datëlindjes 04.06.1970 , i lindur ne Markaj, Bajram Curri dhe banues në Tirane , person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 034249278 dhe nr. personal H00604186T dhe emerohet per nje afat 5- vjecar

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e tij ne kete detyre per nje periudhe pese vjecare nga data e fitimit te personalitetit juridik te shoqerise dhe regjistrimit te saj prane organeve kompetente shteterore sipas parashikimeve te percaktuara ne ligj.

NENI 12

KOMPETENCAT

Shoqeria administrohet vetem nga nje administrator i vetem.. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem. Administratori mund te perfaqesoje shoqerine perpara te gjithë personave juridike apo fizike, publike dhe/ose private, vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja perfshire ketu te gjitha autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji shprehimisht ia jep ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredhenie me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Administratori gjithashtu ka te drejta te nenshkruaje kontrata te ndryshme ne emer e per llogari te shoqerise perfshire ketu kontratat e shitjes, blerjes, qerese, hipotekimit te pasurive te paluajtshme te nenshkruaje aketet e themelimit te shoqerive te tjera ku shoqeria është ortak te nenshkruaje te hartoje cdo dokument e te kryeje ne emer te shoqerise cdo veprim perballe te gjitha Bankave shqiptare apo te huaja ne lidhje me celjen ne llogarite rrjedhese te shoqerise, nenshkrimin e kontratave te ndryshme bankare per financimin e shoqerise si dhe te kryeje veprime terheqje e dërdhje shumash nga keto llogari pa limit.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti I administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena duke pasur parasysh faktin vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Klauzolat e ktij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit te cilat rrjedhin nga ky nen duhet te respektohen nga te tretet.

NENI 13

PERGJEGJESITE



STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
"BREÇANI" SH.P.K

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve për shkelje të ligjit për shkelje të statutit apo për fajë të krijuara gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamarituara nga ortakët i vetëm që i sjellin dem shoqërisë i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

NENI 14

VITI FINANCIAR

Viti financiar I shoqërisë fillon me datë 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht viti i parë financiar fillon që nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet në datën 31 Dhjetor .

NENI 15

BILANCI I SHOQËRISË DHE DIVIDENTET

Brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar Mbledhja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë miraton bilancin e paraqitur nga administratori

NENI 16

EKSPERTI

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontrabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë të gjithë vitit dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë I ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm të shoqërisë.

NENI 17

BASHKIMI DHE NDARJA

Shoqëria me anë të bashkimit mund të kalojë asetet e saj një shoqërie tjetër ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo po themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund të kalojë asetet e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose shoqërive të reja .

NENI 18

MOSMARRËVESHJET

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë .

NENI 19

BAZA LIGJORE

Shoqëria deklarohej të krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .



STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
"BREÇANI" SH.P.K

NENI 20

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Akti i themelimit dhe statuti u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "Breçani" shpk.

Akti i themelimit dhe statuti nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem.

Ortak i vetem themelues i
Shoqerise "Breçani" shpk.
Erzen Breçani

Erzen Breçani

